

Neni 28

Zëvendëskryetari i Bashkisë

Në strukturën e saj Bashkia Malësi e Madhe ka dy zëvendëskryetar, të cilët emërohen dhe shkarkohen nga Kryetari i Bashkisë. Puna e tyre është e ndarë në mënyrë të tillë që një nga zëvendëskryetarët :

- a) Të organizojë punën sipas fushave në varësi, bazuar në kompetencat dhe detyrat e dhëna nga Kryetari i Bashkisë dhe përgjigjet para tij për mbarëvajtjen e tyre;
- b) Bashkëpunon me të gjithë drejtuesit e drejtorive, sektorëve dhe institucioneve vartëse, veçanërisht me drejtoritë që i ngarkon kryetari, duke i kërkuar e dhënë ndihmën e nevojshme, për realizimin e detyrave funksionale;
- c) Harton programe e politika zhvillimi, të cilat i paqarqet para Kryetarit të Bashkisë për miratim;
- d) Ndjek hartimin e p/buxhetit të vitit dhe asiston drejtoritë përkatëse, deri në miratimin e tij në Këshillin e Bashkisë;
- e) Ndjek me përgjegjësi treguesit e buxhetit dhe i raporton herë pas here Kryetarit të Bashkisë, duke i propozuar edhe masa konkrete, për përmirësimin e gjendjes financiare të bashkisë;
- f) Si detyrë të deleguar nga Kryetari i Bashkisë, zëvendëskryetari merr kontakte të vazhdueshme dhe mbledh drejtuesit e drejtorive, apo të sektorëve, për problemet që shqetësojnë punën e bashkisë;
- g) Zëvendëskryetari tjetër :
- h) Konfirmon shkresa zyrtare për organet qendrore, vendore apo subjekte të ndryshme, në emër dhe në mungesë të Kryetarit të Bashkisë;
- i) I jep mendime Kryetarit të Bashkisë, për punën dhe aftësinë në kryerjen e detyres së çdo drejtorie, drejtuesi apo specialisti në veçanti;
- j) Bashkërendon punën me Sekretarin e Përgjithshëm, për realizimin në bllok të të gjitha detyrave që përmban kjo rregullore, apo të dhëna nga titullari i bashkisë;
- k) Ushtron të gjitha kompetencat në kryerjen e funksioneve të bashkisë dhe përfaqëson këtë institucion në të gjitha rastet kur me autorizim të Kryetarit të Bashkisë kjo e drejtë i delegohet.

Në këto raste zëvendëskryetari përgjigjet para Kryetarit të Bashkisë për realizimin e funksioneve të deleguara.

Paga pozicionit e miratuar me vendim të keshillit bashkiak : 92,500